



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 nëntor 2013  
Nr.ref.:RK506/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI122/13**

Parashtrues

**Rizah Llumnica**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së  
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2011,  
të 8 prillit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rizah Llumnica nga Prishtina, i përfaqësuar nga z. Halil Palaj (parashtruesi).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin Rev. nr. 12/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 prillit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 21 maj 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 13 gusht 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 30 gusht 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama.
7. Më 11 shtator 2013, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai vërtetimin, i cili e konfirmon datën e pranimin të njoftimit në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Në të njëjtën datë, Gjykata e informoi edhe Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën.
8. Më 24 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi vërtetimin e kërkuar në lidhje me pranimin e njoftimit.
9. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 4 korrik 2001, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Komunës së Prishtinës për konfirmimin e së drejtës së tij për pronën e paluajtshme.
11. Më 8 qershor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin (C. nr. 733/01), e refuzoi padinë si të pabazuar.

12. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të së drejtës materiale.
13. Më 21 shtator 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin (Ac. nr. 146/2008) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se *“pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me kërkesëpadi, vërtetimin e së drejtës pronësore, por kanë të bëjnë ekskluzivisht me procedurë dhe aktvendim për eksproprijim, të vitit 1976”*, të cilat janë dy procedura të ndryshme dhe se *“padiësi kundër aktvendimit të cekur ka mundur të iniciojë vetëm konflikt administrativ, në kuptim të nenit 3 të Ligjit për konfliktin administrativ.”*
14. Më 27 tetor 2010, parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pretenduar se *“kjo pronë e paluajtshme ishte pronë private e babait, gjyshit dhe stërgjyshit të padiësit, ku ai ka jetuar me familjen e tij dhe nuk ka asnjë ligj në botë dhe në vendet me demokraci funksionale, që është gjithashtu i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, që do të mund t’ia mohonte të drejtën e tij pronësore dhe njohjen e së drejtës pronësore”*.
15. Më 8 prill 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 12/2011), e hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin e parashtruesit, sepse *“vlera e kësaj lënde kontestimore nuk ka qenë fare e caktuar në padi, ndërsa padiësi ka paguar taksa gjyqësore për padi në shumë prej 20 DM, e që sipas regjistrit për taksa gjyqësore të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili ndodhet në shkresat e lëndës, nënkupton vlerën e kontestit prej 25-250 eurosh, rezulton se kjo vlerë e kontestit prej 250 eurosh, për të cilën është paguar taksa gjyqësore në shumë prej 20 DM, nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 382 paragrafi 2 i LPK-së, lidhur me nenin 2 nën pika (i) e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/10”*.

### **Pretendimet e parashtruesit**

16. Parashtruesi pretendon shkelje të nenit 46 dhe 31 të Kushtetutës, duke theksuar se *“është shkelur e drejta e garantuar e pronës së tij, sepse prona e tij që ishte në pronësi të babait të Rizah Llumnicës, prej 80 vitesh, ishte shpronësuar jo për interesa publike, por personale, për inspektorë të Sigurimit Shtetëror. E drejta e pronës private është e shenjtë, e paprekshme dhe e pacenueshme.”*
17. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që ta *“anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2011, të 8 prillit 2013 dhe të urdhërojë shqyrtimin meritor të revizionit.”*

## Pranueshmëria e kërkesës

18. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë së kërkesës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*

*(...)*

*“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh”.*

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka kërkuar ndihmë për t'i mbrojtur të drejtat e tij në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut, dhe përfundimisht, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit i ishte dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 15 korrik 2013 dhe ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 21 maj 2013.

22. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e aplikueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katër mujor.

23. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa i plotëson kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 49 të Ligjit.

24. Sidoqoftë, Gjykata duhet ta marrë parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)”.*

25. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.”*

*(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...],*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;ose*

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Gjykata vëren se parashtruesi ka kontestuar në Gjykatën Supreme aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ai në Gjykatën Kushtetuese konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme, sepse me vendimin e kontestuar i janë shkelur “e drejta e garantuar e pronës” dhe “e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.”
27. Gjykata vëren më tej se Gjykata Supreme ka hedhur poshtë revizionin e parashtruesit si të palejuar, sepse “vlera e kontestit prej 250 eurosh, për të cilën është paguar taksa gjyqësore në shumë prej 20 DM, nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 382 paragrafi 2 të LPK-së lidhur me nenin 2 pikën (i) të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/10”. Prandaj, vlera e kontestit e përcaktuar në këtë mënyrë nga Gjykata Supreme ishte 250 euro, që është shumë më e ulët se pragu prej 800 eurosh, në mënyrë që revizioni të jetë i lejueshëm sipas Ligjit për procedurën kontestimore.
28. Gjykata konsideron se arsyetimi i ofruar nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i qartë dhe i arsyetuar mirë duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit.
29. Në anën tjetër, parashtruesi nuk qartëson saktësisht se si dhe pse vendimi i Gjykatës Supreme duke hedhur poshtë revizionin për shkak të pamjaftueshmërisë së vlerës monetare ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.
30. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu rastin KI70/11, të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
31. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë sa që procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë, sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër të tjera, *inter alia*, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
32. Gjykata konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ishin të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
33. Në përmbledhje, parashtruesi as nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të

drejtave të tij kushtetuese (Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, nr. 53363/99, Vendimi i GJEDNJ-së, i 31 majit 2005).

34. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe (2) b) dhe d) dhe 56 (2) të Rregullores, më 21 tetor 2013, njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani